



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
NGRITJE NË DETYRË  
NË KATEGORINË E MESME DHE E ULËT DREJTUESE**

**“Pergjegjes i Sektorit te Sherbimit Social”**

Në zbatim të neneve 25 dhe 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Roskovec shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

**1. Pergjegjes i Sektorit te Sherbimit Social, Klasifikuar - Kategoria: III-a**

*Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.*

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË )  
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:  
LËVIZJE PARALELE**

**28 MARS**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:  
NGRITJE NË DETYRË**

**2 PRILL**

- Mbulon cdo ceshtje qe lidhet me strehimin
- Harton politikat për kujdesin social, mbledh dhe analizon informacionin mbi situatën sociale të shtresave në nevojë dhe kategorive në risk;
- Harton dhe monitoron strategjitë dhe programet afatmesme dhe afatshkurtër, që ndihmojnë kategori të veçanta për të kapërcyer barrierat ekonomike dhe sociale;
- Harton dhe kontrollon projektet sociale, përcakton prioritetet, si dhe harton buxhete për realizimin e programeve sociale;
- Harton dhe monitoron standardet dhe kriteret prioritare për të gjithë sektorët e kujdesit social, përfshirë edhe strehimin social;

- Zbaton dhe menaxhon projekte sociale për të gjitha kategoritë në nevojë dhe bashkëpunon me të gjithë aktorët përgjegjës: organizatat jofitimprurëse dhe organizma të tjerë, për realizimin e tyre;
- Merr pjesë si palë e tretë dhe shpreh mendimin si ekspert në fushën sociale në gjykimin e çështjeve civile mbi “Caktimin e kujdestarisë së personave që u hiqet apo kufizohet zotësia për të vepruar”, në përputhje me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”;
- Bashke me specialistet e ndihmes ekonomike organizon vizita në familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike, për të verifikuar gjendjen reale të tyre dhe ndryshimet që mund të kenë ndodhur
- Merr pjesë si palë e tretë dhe shpreh mendimin si ekspert në fushën sociale në gjykimin e çështjeve civile mbi “Caktimin e kujdestarisë së fëmijëve”, në përputhje me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”;
- Zbaton projektet e ndryshme sociale si dhe ndjek dhe ndihmon në zhvillimin e aktiviteteve sociale për të gjitha kategoritë në risk, përfshirë këtu aktivitetet e Rrjeteve Sociale të ngritura për mbështetjen e kategorive sociale;

## LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-a
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:**

- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" ne Shkenca Humane, Shoqerore, Drejtesi, Sociale etj;
- Të kenë të paktën 5 vjet përvojë pune ne administraten shtetërore vendore.

### 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- Jetëshkrim
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen dorazi prane Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: 28.03.2018**

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **30.03.2018** Njesia Pergjegjese bene verifikimin paraprak te kandidatave qe plotesojne kushtet dhe kriteret e vecanta te percaktuara ne shpalljen ne konkurim. Brenda kesaj date Njesia Pergjegjese bene shpalljet e kandidatave te kualifikuar ne fazen e verifikimit paraprak ne faqen e sherbimit kombetar te punesimit si dhe ne stenden e informimit te publikut te bashkise Roskovec .

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Kandidatet te cilet rezultojne te pakualifikuar brenda 3 (tre) diteve nga shpallja e listes paraprake te verifikimit te kandidatave, ne daten **03.04.2018** kane te drejte te paraqesin ankesat e tyre ne njesine e menaxhimit te burimeve njerezore. Brenda 3 (tre) dite pune nga data e paraqitjes se ankeses me date **10.04.2018** Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore u kthen pergjigje kandidatave te pakualifikuar.

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

---

#### **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

1. [Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit",](#)
2. [Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik"](#)
3. [Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit "](#)
4. [Ligji Nr.9355, datë 10.03.2005, Ndryshuar me ligjin nr. 9602 datë 28.07.2006, ligjin nr. 10252 datë 11.03.2010, ligjin nr.25/2013, ligjin nr. 47/2014, ligjin nr. 44/2016 "Për Ndhmën dhe Shërbimet Shoqërore"](#)
5. [Vendim Nr. 18, datë 12.1.2018 "Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë"](#)
6. [Vendim Nr. 955, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike "](#)
7. [Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhmës Ekonomike"](#)
8. [Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.277, datë 13.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", i ndryshuar](#)
9. [Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.31 datë 20.01.2001, "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar.](#)
10. [Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.618, datë 07.09.2006, "Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar.](#)

11. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.869 datë 18.06.2008, "Për zbatimin e Ligjit Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit".
12. Vendim Nr.431, datë 08.06.2016 "Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot".

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

---

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pikë, **i ndare ne:**

- 20 pike per pervojen,
- 10 pike per trajnimet lidhur me fushen perkatese
- 10 pike per vlesimet pozitive

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikeve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Intervista e strukturuar me goje do te zhvillohet ne daten **16.04.2018** ora 11:00.

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të ne date 18.04.2018 do te njoftoje individualisht kanditate e tyre per rezultatet e tyre

Kandidat pavarësisht nga e drejta për të ankuar në gjykatën administrative kanë të drejtë të bëjnë ankime me shkrim edhe në Komitetin e Pranimi dhe për levizje paralele për rezultatin e pikeve të tyre, brenda tre ditëve kalendarike nga datat e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi mer përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të njoftimit. Njesia Përgjegjëse e Burimeve Njerezore ne date 30.04.2018 shpall listen e kandidatit fitues. Shpallja e fituesit publikohet në faqen e Sherbimit Kombëtar të Punësimit dhe në stendin e informimit të Bashkisë Roskovec.

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

### 2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV-a, IV-b;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Humane, Shoqerore, Drejtësi, Sociale etj;  
" në Shkenca Juridike, Fakulteti i Drejtësisë;
- b- Të kenë të paktën 2 vjet përvojë pune në administratën shtetërore vendore;

### 2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a - Jetëshkrim
- b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen dorazi pranë Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerezore brenda datës: **02.04.2018**

### 2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12/04/2018**, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

**Brenda 5 diteve kalendarike nga data e shpalljes se listes kandidatet e pakualifikuar kane te drejte te paraqesin ankese prane Njesise se menaxhimit te burimeve njerezore deri me date 17.04.2018. Ankuesi merr pergjigje brenda dates 24.04.2018.**

## **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim me date 27.04.2018 ne lidhje me:**

- 1 - Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”.
- 2 Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”
- 3 Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit ”.
- 4 Ligji Nr.9355, datë 10.03.2005, Ndryshuar me ligjin nr. 9602 datë 28.07.2006, ligjin nr. 10252 datë 11.03.2010, ligjin nr.25/2013, ligjin nr. 47/2014, ligjin nr. 44/2016 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shogërore”
- 5 Vendim Nr. 18, datë 12.1.2018 “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë”
- 6 Vendim Nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhimës Ekonomike “
- 7 Vendim Nr. 956, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e Ndhimës Ekonomike”
- 8 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.277, datë 13.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar
- 9 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.31 datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar.
- 10 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.618, datë 07.09.2006, “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar.
- 11 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.869 datë 18.06.2008, “Për zbatimin e Ligjit Nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit ”.
- 12 Vendim Nr.431, datë 08.06.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

**2.6****DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

---

Komisioni i Ngritjes ne detyre brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pra më date **30.04.2018**

I ve ne dispozicion listen e fituesve, Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Kandidat pavarsisht nga e drejta per ty ankuar ne gjykatën administrative kane te drejte te beje ankim me shkrim edhe ne Komitetin e Pranimit per Ngritjen ne Detyre dhe per levizje parale per rezultatin e pikeve te tyre, brenda tre diteve kalendarike nga data e njoftimit individual per rezultatin e vleresimit .Ankuesi mer pergjigje brenda 5 diteve kalanderike nga data e perfundimit te afatit te njoftimit.Njesia Pergjegjese e Burimeve Njerezore ne date **08.05.2018** shpall listen e kandidatit fitues.Shpallja e fituesit publikohet ne faqen e Sherbimit Kombetar te Punesimit dhe ne stenden e informimit te Bashkise Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne : e-mail :  
[evisa.mustafaj@yahoo.com](mailto:evisa.mustafaj@yahoo.com)

**NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE**

**BASHKIA ROSKOVEC**